

Kosovo Security Barometer

Edicioni 1
Dhjetor 2012



Qellimet e Barometrit?

Barometri i Sigurise eshte dizajnuar si instrument inovativ qe publikohet dy here mbrenda vitit dhe i cili ka qellim qe te sjell ne siperfaqe opinionet e qytetareve rreth sigurise dhe drejtesise sikuresse edhe sfidave te sigurise me te cilat ballafaqohet Kosova. Iniciativa eshte e ngjashme por edhe e vecante krahasuar me publikime nderkombetare. Ky publikim ndryshon ne menyre te dukshme per shkak te fokusit te tij kryesisht ne siguri dhe

drejtesi, per pavaresine shkencor te institucionit por edhe faktin qe nuk ka ndonje kufizim te caktuar politik per komunikimin e gjetjeve. Ne anen tjeter, publikimi eshte iniciativa e pare lokale e ketij lloji dhe ne kete menyre tregon rendesine e perpjekjeve te donatoreve per krijimin e nje shoqerie civile te qendrueshme. Publikimi eshte poashtu i vecante per metodologjine e tij – ndoshta do te jete publikimi i pare tradicional i ketij lloji dhe i cili bazohet ne anketimin e opinionit publik.

Audienca jone

QKSS ka si qellim te plotesoj qasjen e saj per te sjellur opinionet e qytetareve ne procesin e politike-berjes sikur ishte edhe anketa ne lidhje me performancen e kompanive te sigurimit privat dhe qasjet e bazuara ne komunitet ne sektorin e drejtesise. Kjo initiative korrespondon edhe me nje periudhe kohore te ndjeshmerise ne kuader te sektorit te sigurise dhe drejtesise por edhe kompleksitetet e struktures demografike, multi-etnicitetit dhe marredhenieve mjaft komplekse

me vende te caktuara ne rajon. Ndikimi i publikimit pritet te rritet ne afat-mesem per nje numer arsyesh duke perfshire (a) kredibilitetin e qendres se institucionit i pavarur, (b) pervaia e institucionit ne perdorimin e metodave te duhura shkencor ne hulumtim, (c) rendesine e pronesise lokale dhe (d) kapacitetet e disponueshme ne kuader te institucionit.



Mbeshtetur nga:



“Kjo eshte iniciativa e pare nga nje qender lokale studimore. Ne kemi qellim te kontribojme ne reformin institucional dhe permiresimin e praktikave te sigurise”

Florian Qehaja, KCSS
Drejtor Ekzekutiv

Ekipi Hulumtues:

Mr. Armend Muja,
Director of Research

Mr. Skender Perteshi,
Field Research
Coordinator

Ms. Fjolla Raifi, Data
Entry Manager

Ms. Sofije Kryeziu,
Field Supervisor

Metodologjia

Raporti ofron një përmbledhje të perceptimeve të qytetarëve rreth sigurisë në Kosovë, performancës së institucioneve të drejtësisë, natyrës së rreziqeve të jashtme dhe të mbrendshme, stabilitetit politik, sigurisë ekonomike dhe mjedisit. Anketimi është realizuar përmes intervistave sy-me-sy në gjithë Kosovën duke përdorur pyetorin e zhvilluar nga QKSS. Të gjitha pyetjet ishin të mbyllura dhe shumica syresh ishin të bazuara në shkallët e Likertit. Mostra, testimi dhe intervistimi janë realizuar nga QKSS dhe ka përfshirë rreth 20 hulumtues terreni. Mostra kombëtare përfaqëson popullatën e Kosovës 18 e më të vjetër. Gjithsej janë intervistuar 1067 amviseri. Struktura etnike e mostrës ishte si në vijim: Shqiptarë 89%, Serbë 7% dhe minoritete tjera 4%.


Korniza e mostrës bazohet në kodet e zonave telefonike dhe përfshin rajonet e Prishtinës, Mitrovicës, Prizrenit, Ferizaj, Gjiçan, Pejë dhe Gjakovës. Pas fazës së parë të kategorizimit gjeografik të bazuar në raportin e fundit të Entit Statistikor të Regjistrimit të Popullsisë, është bërë kategorizimi i mostrës sipas komunave duke përfshirë edhe proporcionalitetin rural/urban. Faza e fundit është bazuar në zgjedhje të rëndomte sipas teknikes së 'ditelindjes me të afert'. Mostra e rëndomte siguron që secili banor në Kosovë ka probabilitet të njëjtit për t'u zgjedhur për intervistim. Margjina e gabimit është +/- 3 dhe intervali i besueshmërisë është 95%.


Para se të fillonte hulumtimi në terren gjatë nëntorit 2012 janë bërë disa prova dhe teste për cilësinë e pyetjeve dhe pyetorin. Ekipi hulumtues ka raportuar se pilotimi ishte i suksesshëm dhe nuk ishte ballafaqur me ndonjë problem. Të gjitha intervistat janë kompletuar ndërmjet 1 Nëntor - 1 Dhejtor 2012. Përpunimi i të dhënave është bërë duke përdorur softuerin SPSS.

Përzgjedhja e institucioneve është bërë duke u bazuar në praktiken e QKSS për vlerësimin e institucioneve të sektorit të sigurisë. Praktikantët e reja të menaxhimit të ri publik kërkojnë një politikë-berje të bazuar në evidence. Në esencë politikë-berja kërkon që të kemi marrje të inputeve nga popullata në mënyrë të vazhdueshme për matjen e performancës. QKSS ka futur në funksion kapacitetet e saja të brendshme si dhe ekspertinë në mënyrë që të komplementohen përpjekjet e akterëve vendor dhe ndërkombëtar. Lirisht mund të thuhet se rëndësia e kësaj konsiston me procesin e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë. Perceptimet e prezentuara në këtë raport janë përmbledhje e informacioneve të ofruara nga të anketuarit dhe si rrjedhojë këto paraqesin vetëm perceptimin e qytetarëve ndaj institucioneve. Kjo në asnjë mënyrë nuk paraqet një vlerësim lidhur me kualitetin e punës së institucioneve në fushat respektive. Ky raport pritet të shërbejë si një instrument për adresimin e dobësive potenciale por edhe si indikator për e efektivitetin të këtyre institucioneve në komunikim me qytetarët. Një analizë e detajuar si dhe raporti do të ofrohen në një fazë të mëvonshme.

Knaqeshmeria me institucionet e sigurise dhe perceptioet ndaj sigurise publike

Të anketuarit janë pyetur lidhur me kënaqshmërinë e tyre me punën e institucioneve të sigurisë duke dhënë mendimin e tyre bazuar në shkallët – 1 shumë i pakënaqur, 2- I pakënaqur, 3 – disi i kënaqur, 4- I kënaqur, 5 – shumë i kënaqur dhe 0 – pa opinion apo nuk është përgjigjur. Të anketuarit më së shumti janë shprehur të kënaqur me punën e Forcës së Sigurisë së Kosovës (72%) përcjellur nga KFOR-i (60%) si dhe zjarrefikësit (57%). Një kënaqshmëri e balancuar është ndaj Policisë së Kosovës me vetëm 42% të të anketuarve që shprehën kënaqshmëri me punën e tyre. Më së paku kënaqshmëri ka ndaj punës së Doganave (29%) dhe EULEX-it (22%). Të anketuarit janë pyetur lidhur me punën e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI) megjithatë kjo prodhoi rezultate jokonkluzive përderisa 60% u përgjigjën se nuk kanë informacion lidhur me këtë institucion dhe si rrjedhojë nuk mund të japin vlerësim lidhur me të. Ata të cilët shprehën vullnetin për të dhënë mendim lidhur me AKI ishin të pakënaqur me performancën e këtij institucioni (27%). Serbët e Kosovës në përgjithësi kanë nivel të ulët të kënaqshmërisë ndaj institucioneve (më së shumti kënaqshmëri ndaj Policisë me 23%). Shumica e serbëve duket se janë të pakënaqur me punën e KFOR-it dhe EULEX-it.






A e konsideroni EULEX/KFOR fer dhe te panshem?


Të anketuarit janë pyetur lidhur me atë se a pajtohen apo nuk pajtohen me deklaratën më poshtë "EULEX/KFOR është fer dhe i paanshëm"? Shumica u pajtuan me pyetjen për KFOR-in kurse kishin mendim të kundërt lidhur me EULEX-in.

A duhet qe FSK te shendrohet ne ushtri?

Në pyetjen se a pajtohen apo nuk pajtohen me deklaratën e mëposhtme " A duhet Forca e Sigurisë se Kosovës të shëndërrohet në Ushtri"? shumica dërmuese (87%) u përgjigjën pozitivisht në krahasim me vetëm 7% të cilët mendojnë ndryshe.



Kenaqeshmeria me institucionet e drejtesise




Sa i përket gjyqësorit, të anketuarit në përgjithësi kishin shprehur dyshime dhe besim të ulët. Gati 60% e tyre thanë se nuk kanë besim në sistemin gjyqësor. Kënashmëria e tyre me punën e gjykatave të Kosovës qëndron në nivelin e 8%, ndersa rreth 36% të tjerë mendonin se ishin pak të kënaqur. Gjysma e të intervistuarve thanë se janë shumë të pakënaqur me punën e gjykatave të Kosovës. Në pyetjen se cilat janë arsyet që shtojnë këtë pakënaqësi, rreth 36 % e tyre deklaruan se gjykatat në Kosovë punojnë shumë ngadalë, mendim ky i përcjellur nga 28% të cilët mendojnë se nuk besojnë në gjykata dhe 12 % të tjerë të cilët thanë se ju mungon informacioni. Të tjerët ishin të ndarë në mes të mungesës së mënyrave alternative për të i zgjedhur problemet, distancës nga shtëpia e kështu me radhe. Hulumtuesit tanë kishin pyetur të


anketuarit nëse pajtohen apo nuk pajtohen me thënjen “Gjykatat janë të pavarura” ndërsa vetëm 14% e tyre kishin thënë se pajtoheni.

Perceptimet ndaj rreziqeve të jashtme dhe marrëdhënieve ndërkombëtare

Ekipi jonë hulumtues ishte i interesuar gjithashtu të kuptonte natyrën e kërcënimeve që ata i perceptojnë. Impakti i mundshëm i krizës ekonomike ishte konsideruar si kërcënim më i lartë për të cilin respondentët ishin të shqetësuar (75%). Ata parapanë kërcënim të vogël apo nuk kishin paraparë fare kërcënim nga sulmet e mundshme ushtarake dhe terrorizmi ndërkombëtar. Megjithatë, gati 40% i shihnin importimin e ideve dhe stilit të jetës nga jashtë si kërcënim potencial për shoqërinë e Kosovës – potencialisht duke shprehur forma rezistence ndaj globalizimit si fenomen. Dallime jo shumë të mëdha janë vërejtur sa i përket perceptimeve të respondentëve të etnive të ndryshme. Në pyetjen e shtuar për të vlerësuar nivelin e kërcënimeve që ju kanosen nga ana e shteteve fshinjë rreth 70% ndjenin rrezik të caktuar që Kosovës i kanoset nga ana e Serbisë. Vetëm një përqindje e shpërfillshme kishin opinione të njëjta edhe drejt Shqipërisë, Maqedonisë e Malit të Zi.



Sa miqësore i vlerësoni shtetet/institucionet në vazhdim?




Respondentëve ju kishte shtuar pyetja edhe sa mike apo jo-mike i konsiderojnë akterët ndërkombëtar të cilët kanë ndikim në siguri dhe zhvillimet politike të Kosovës. Shqipëria, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Turqia dhe Bashkimi Evropian janë vlerësuar si shtete/institucione

mike. Maqedonia dhe Mali i Zi shiheshin si shtete neutrale nga shumica e të intervistuarve. Ndërsa Serbia e pasuar nga Greqia dhe Rusia nga shumica dërmuese shiheshin si shtete jo-mike në raport me Kosovën. Nëse i vlerësojmë nga këndvështrimi etnik i respondentëve, këtu vërehet një dallim i madh në opinione tek respondentët Serb të Kosovës, ku për ta Serbia, Rusia dhe Greqia shiheshin si vendet më mike nga pjesa tjetër e shteteve të përfshira në sondazh. Më shumë Serb të Kosovës (rreth 36%) shihnin Bashkimin Evropian si jomik sesa mik (30%). SHBA-të dhe Shqipëria i prinin listës së shteteve jo-mike për Serbët e Kosovës. Megjithatë, perceptimi i Serbëve të Kosovës ndaj Shqipërisë si vend jo-mik është substancialisht më i vogël sesa ai i Shqiptarëve të Kosovës ndaj Serbisë.

Siguria e Kosoves do te garantohej me se miri sikur?

Në pyetjen drejtuar respondentëve që të shprehin opinionin e tyre se cila është mënyra më e mirë për të garantuar sigurinë në Kosovë, respondentët vlerësonin anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe investimet në sektorin e mbrojtjes si hapat më efektiv që duhej ndërmarrur. Vetëm 18% mendonin se për të arritur një gjë të tillë Kosovës i duhet prezenca e vazhdueshme e NATO-s. Të bërit paqe me fqinjët ishte konsideruar si opsioni më pak i rrumbullakuar (me 11%).




A duhet zvogeluar numri i trupave te KFOR?

Rreth 50% e të gjithë respondentëve thanë se numri i pjesëtarëve të KFOR-it duhet të mbetet i njejtë – pjesa tjetër ishin pothuajse baraz të ndarë në atë se KFOR duhet të reduktohet apo do duhet që ky mision të ketë pjesëtar shtesë. Shqiptarët e Kosovës ishin më të interesuar që shohin KFOR-in më tepër të koncentruar në pjesën veriore të Kosovës.

Siguria politike – perceptimet e rrezikut

Si e vleresoni rrezikun nga?




Ekipi hulumtues kishte zhvilluar një mori pyetjesh për të kapur perceptimet e qytetarëve rreth rreziqeve të cilat kanë potencial që ta sfidojnë sigurinë politike të Kosovës. Megjithëse pyetjet ishin modeluar nga këndvështrimi inkluziv, ekipi hulumtues kishte identifikuar një numër të caktuar të burimeve potenciale të rreziqeve përmes observimit të temave ditore të ngritura në opinionin e skenës publike të Kosovës. Çështja e veriut të Kosovës, situata ekonomike dhe korrupsioni në përgjithësi shihen si faktorët kryesor që e rrezikojnë stabilitetin politik të Kosovës. Ndasitë e skenës politike


të Kosovës dhe potenciali i ndikimit të përpjekjeve në mes të partive politike rivale zgjuan vëmendje më të vogël. Respondentët ishin më pak të prirur që të shohin ndonjë ndryshim të nxitur nga faktorët e jashtëm, mungesa e lirisë së të shprehurit dhe liria e lëvizjes. Gjithashtu në pëto pika nuk ishte vërejtur ndonjë diferencë e madhe në opinione edhe kur analizohen opinionet e respondentëve të etnive të ndryshme.

Respondentët gjithashtu ishin pyetur që të vlerësonin situatën politike në Kosovë dhe nëse ata i besonin situatës ekzistuese politike në Kosovë si dhe për besimin që kanë ndaj institucioneve demokratike dhe praktikave të tyre. Gati 60% e të intervistuarve vlerësuan situatën e tanishme politike si të keqe. Po ashtu, kur janë pyetur se nëse ata pajtohen me thirrjen në vijim "Institucionet e Kosovës përfaqësojnë interesin tim" 67% e tyre nuk pajtoheshin me këtë mendim. Pjesa më e madhe e tyre (52) theksuan se ata do të donin që të kontaktojnë institucionet drejtpërsëdrejti çdo herë që kanë nevojë shërbimet apo kujdesin e tyre, por një numër i konsiderueshëm prej 40% ishin të mendimit se lidhjet familjare, nder-personale si dhe ato partiake ishin alternativat më të preferueshme të tyre. Besimi i ulët i të anketuarve ndaj sistemit elektoral ishte cuditërisht i ulët – rreth 52% raportuan se kanë shumë pak besim në sistemin zgjedhor.

Do you trust the electoral system?



Do you support Belgrade-Prishtina dialogue



Respondents Të anketuarit ishin të ndarë në dysh sa i përket lidhur me dialogun Prishtinë-Beograd. Rreth 47% deklaruan se mbështesin dialogun. Në pyetjen se nëse ishin të mendimit se dialogu i kontribon stabilitetit, rreth 45% deklaruan se shpresojnë në këtë. Serbët kishin më shumë shpresë dhe si rrjedhojë mbështetën më shumë dialogun (55%) mirëpo me më pak shpresë se sa shqiptarët sa i përket rezultateve të këtij dialogu.


Economic security

Ekipi hulumtues ka zhvilluar indeksin e sigurisë ekonomike në Kosovë. Përceptimet ekzistuese do të shërbejnë si bazë për të matur besimin e të intervistuarve në ekonomi dhe në ndryshimet e të ardhurave të tyre. Duke konsideruar situatën e tanishme ekonomike si dhe ndikimin e mundshëm të krizës ekonomike evropiane dhe borxhit të Kosovës, baza ekzistuese është paraqitur të jetë negative.


Gjersa Qeveria ka arritur të kompensoj ndikimin negativ të rritjes së shpenzimeve publike në vepra të mëdha publike dhe

ritje në pagat e nëpunësve publik, duhet gjithashtu të theksohet se Kosova ka përjetuar nivele më të larta të inflacionit se sa të zakonshmet. Gjithashtu, përceptimet negative të opinionit janë ndikuar nga humbjet e të ardhurave të emigrantëve si dhe humbjet potenciale të të hollave si rezultat i krizës financiare. Afro 50% e të intervistuarve ishin të mendimit se ekonomia e Kosovës gjatë këtij viti është përkeqësuar dukshëm në krahasim me vitin e kaluar [2011]. Në pyetjen rreth ndryshimeve të mundshme në të ardhurat e tyre me vitin e kaluar - 34% e të intervistuarve deklaruan se niveli i të ardhurave të tyre është përkeqësuar në krahasim me një vit më parë. Ndërsa, vetëm 21% kanë raportuar përmirësim në të ardhura. Baza e indeksit të sigurisë ekonomike përcaktohet të jete (-13) për qind. Ndërsa të anketuarit kanë raportuar humbje në të ardhura, si dhe perceptim të zyrtë të ekonomisë, duke qene shumë skeptik dhe aspak optimistë në përmisime të mundshme në vitet e ardhshme.

Ky vit krahasuar me një vit më parë




Your expenditure-incomes



Të intervistuarit gjithashtu u pyetën rreth nivelit të të ardhurave të tyre duke u dhënë mundësinë e zgjedhjes së një prej alternativave të mëposhtme që shpjegon gjendjen e tyre ekzistuese: (a) Jam duke kursyer, (b) Te hyrat janë të mjaftueshme, (c) Kam probleme, (d) Kam probleme shumë të mëdha. Rreth 5% deklaruan se kishin të ardhura të mjaftueshme dhe po kursenin, ndërsa 26% deklaruan se të ardhurat e tyre janë të mjaftueshme. Ndërsa, një përqindje e konsiderueshme (42%) raportuan për probleme të vogla rreth mbulimit të shpenzimeve të tyre. Kurse pjesa tjetër (27%) raportuan të kenë probleme të mëdha në mbulimin e shpenzimeve nga të ardhurat e tyre mujore.


Siguria shoqërore dhe perceptimet ndaj rreziqeve të mbrendshme

Të anketuarit janë pyetur për mendimin e tyre rreth rëndësisë së kërcënimeve të sigurisë së brendshme nga sfidat e përmendura më poshtë. Rreziku nga armët pa leje, vjedhjet/vrasjet dhe droga/alkooli janë vlerësuar si rreziqe shumë më të larta në sigurinë shoqërore në krahasim me rreziqet nga konfliktet ndëretnike.



Siguria e mjedisit

Të anketuarit u pyetën nëse ata perceptojnë se shoqëria e Kosovës mund të përballet me çfarëdo lloje sfide (shih grafikun) për sigurinë e mjedisit. Rreziqet kryesore për sigurinë e mjedisit janë raportuar të jenë, shpyllëzimi, humbja e biodiversitetit, si dhe ndotja e ajrit.



Verejtje

Përceptimet e prezantuara në këtë raport janë një përmbledhje e informacioneve të mbledhur nga të anketuarit dhe kjo vetëm tregon se si njerëzit i perceptojnë disa nga institucionet e Kosovës. Kjo përmbledhje, në asnjë mënyrë, nuk është një vlerësim përfundimtar i cilësisë së punës së institucioneve që i nënshtrohen këtij studimi. Kjo do të shërbejë si një instrument për institucionet e përfshira në adresimin e mangësive të mundshme, por edhe një tregues i efektivitetit të komunikimit të tyre me publikun. Një analizë më e detajuar dhe raporti përfundimtar do të përgatiten në një fazë të mëvonshme.

Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë perceptimet e të anketuarve dhe në këtë fazë nuk përfaqësojnë pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë. Qendra do të përshkruajë dhe prezantoj pikëpamjet dhe analiza e veta pas përfundimit të fokus grupeve dhe diskutimeve me informuesit kyç.

Gjithashtu, mendimet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë pikëpamjet e National Endowment for Democracy/ Ndhima Kombëtare për Demokraci(NED).

Kopja e këtij raporti dhe pyetjet duhet drejtuar ne:

Kosovar Centre for Security Studies (KCSS)

Sylejman Vokshi Street
10000 Prishtina, Kosovo

Email: armend.muja@qkss.org; info@qkss.org

Telephone: +381 (0) 38 221 420

Homepage: www.qkss.org

